



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

Drejtoria e Arsimit Parauniversitar

Nr. 101/4 Prot.

Tiranë, më 30.12.2013



MIRATOHET

MINISTRI

LINDITA NIKOLLA

PROGRAMET E ARSIMIT BAZË

(Për klasat e shansit të dytë)

LËNDA: EDUKATË SHOQËRORE

KLASA VI-IX

Tiranë

Dhjetor 2013

SYNIMET E LËNDËS

Edukata shoqërore **synon**:

- të përgatisë të rinjtë dhe të rriturit për pjesëmarrje aktive në shoqërinë demokratike, duke fuqizuar kështu kulturën demokratike;
- të aftësojë të rinjtë në luftën kundër ksenofobisë, dhunës, racizmit, nacionalizmit agresiv dhe intolerancës;
- të sigurojë dhe të forcojë kohezionin shoqëror, drejtësinë sociale dhe në të mirën e përgjithshme;
- të fuqizojë shoqërinë civile përmes pajisjes së qytetarëve me njohuri dhe shprehje demokratike;

Mbështetur në këto qëllime të përgjithshme, **lënda e Edukatës shoqërore synon**:

- t'u japë nxënësve njohuritë dhe t'u zhvillojë aftësitë intelektuale, të domosdoshme për të kuptuar, analizuar dhe për të ndikuar në politikat sociale dhe mënyrat e zbatimit të tyre.
- të zhvillojë aftësitë e pjesëmarrjes qytetare të nxënësve dhe përfshirjen e tyre të vetëdijshme dhe të kualifikuar në zgjidhjen e problemeve të komunitetit.
- të zhvillojë përkushtimin qytetar në respektimin e vlerave dhe parimeve demokratike të domosdoshme për bashkëjetesë në një shoqëri demokratike.

2. KËRKESAT PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT

Programi i lëndës “Edukata shoqërore” për klasat 6-9 zhvillohet në 30 javë, në një orë mësimore në javë. Pra, numri i orëve gjithsej në të cilat zhvillohet programi i lëndës “Edukimi qytetar” është 30, nga të cilat, rreth 60%-70% e orëve janë në funksion të trajtimit të koncepteve të reja, ndërsa 30%-40% e tyre shërbejnë për përpunimin e njohurive.

Dokumentet dhe burimet bazë qëduhet të njihen paraprakisht për zbatimin efektiv të programit janë korniza kurrikulare, standardet e fushës dhe ato të lëndës, të gjitha programet e lëndës së edukatës shoqëroreimit qytetar për ciklin 1-9, programet e lëndëve të tjera, udhëzuesit lëndorë, manualët e vlerësimit.

Zbatimi i programit duhet të bëhet duke respektuar parimet e barazisë gjinore, etnike, kulturore, racore, fetare etj. Objektivat në programe përmbajnë njohuri, aftësi e qëndrime të karakterit të përgjithshëm, ndërlëndor dhe lëndor.

Objektivat grupohen në linja dhe renditja e tyre mund të ndryshojë kur gjykohet e nevojshme nga zbatuesit e programit.

Orët mësimore sugjerohen në kuadrin e linjave, ndërsa ndarja e tyre në funksion të njohurive të reja dhe të përpunimit të njohurive bëhet në bazë të raportit të përcaktuar më sipër. Zbatuesit e programit kanë të drejtë të ndryshojnë numrin e orëve të sugjeruara për linjat në masën 10%.

Përpunimi i njohurive përfshin:

- përsëritjen brenda një kapitulli të njohurive e të koncepteve themelore;
- integrimin e njohurive të reja të një kapitulli me njohuritë e kapitujve paraardhës;
- integrimin e njohurive të reja me njohuritë e lëndëve të tjera;
- përsëritjen vjetore (pavarësisht nga ndarja në linja ose në njësi tematike, lënda duhet parë si një e tërë);
- testimin e njohurive bazë;
- testimin vjetor (ky testim nuk është i detyruar);
- projekte qytetarie në të cilët integrohen aftësitë kërkimore shkencore me grupimet e tjera të aftësive.

3. METODOLOGJIA E MËSIMDHËNIES

Edukata shoqërore është një proces që zgjat gjithë jetën. Si i tillë ai është proces i të nxënës social, domethënë është të nxënë *për, në* dhe *rreth* shoqërisë, në të njëjtën kohë është të nxënës për të jetuar së bashku. Ai nënkupton demokratizimin e të nxënës duke u përqendruar te nxënësi dhe në pavarësinë e përgjegjësinë e tij në procesin e të nxënës, duke nënkuptuar me këtë edhe bashkërendimin e procesit të të nxënës dhe të mësimdhënies.

Edukata shoqërore arrihet nëpërmjet metodave të shumëllojshme e të ndërlidhura të të nxënësve, në të cilin ndërthuren lloje të tilla të edukimit si, për shembull, edukimi i të drejtave të njeriut, edukimi ndërkulturor, edukimi për paqe edukimi global, edukimit nëpërmjet medias etj.

Edukata shoqërore bazohet në përvojën dhe praktikën vetjake. Si i tillë ai kërkon një kurrikul të hapur që të përfshijë metodat pjesëmarrëse dhe ndërvepruese, të cilat bazohen në të nxënësve nëpërmjet përvojës, veprimit dhe bashkëveprimit

Pra, Edukata shoqërore synon të zëvendësojë format tradicionale të mësimdhënies dhe të të nxënësve, në të cilat roli i mësuesit reduktohet në transmetimin e dijeve dhe të aftësive dhe ai i nxënësve në të dëgjuarit pasiv dhe, në rastin më të mirë, në përvetësimin e përmbajtjes së transmetuar. Edukimi për qytetarinë demokratike nënkupton mundësitë e shumta të të mësuarit që ofron “shoqëria e të nxënësve”. Ai del përtej kufijve të shkollës dhe të komunitetit dhe sfidon ndarjen që ekziston ndërmjet edukimit formal dhe atij joformal, ndërmjet veprimtarive kurrikulare dhe atyre jashtëshkollore, si dhe ndërmjet shkollimit dhe shoqërizimit. Si i tillë, ai zhvillon karakterin e ndërsjellë të procesit të mësimdhënies dhe të të nxënësve dhe nxit këmbimin e vazhdueshëm të rolit të mësuesve dhe të nxënësve. Në të njëjtën kohë, duke u përqendruar në fitimin e aftësive dhe të kompetencave të nevojshme për veprimin dhe ndryshimin shoqëror, edukimi për qytetarinë demokratike ruan të gjitha karakteristikat e një përpjekjeje të paramenduar njerëzore që harmonizon teorizimet dhe diskutimin publik.

Në këtë kuadër, mësuesit duhet të shfaqen më tepër si organizatorë të mundësive të shumëllojshme të të mësuarit dhe si ura që lidhin burimet shoqërore me përdoruesit e tyre. Ata ndërmjetësojnë dhe lehtësojnë mundësinë e marrjes së informacionit dhe ndjekin në vazhdimësi sfidat e reja shoqërore, politike dhe teknologjike, si dhe nevojat gjithnjë në rritje të nxënësve të tyre. Nxënësve, gjithashtu, duhet të marrin pjesë aktivisht në vendimet lidhur me procesin edukativ, veçanërisht në ato që lidhen me përmbajtjen, metodat dhe strategjitë e mësimdhënies/të nxënësve për qytetarinë demokratike. Mësimdhënia duhet të bëhet një proces ndërveprues, në të cilin jo vetëm diskutohen qëllimet arsimore, por edhe njihen e shkëmbehen kolektivisht përvojat e fituara

Tërësia e procesit, përfshirë këtu dhe vlerësimin, karakterizohet nga marrëdhënie të ndërsjella. Vlerësimi i dyfishtë dhe përdorimi i të dhënave cilësore për të matur rezultatet e të mësuarit ushtron ndikim të madh në procesin e mësimdhënies dhe të të nxënësve. Kjo praktikë bën që si mësuesit, edhe nxënësit të jenë të përgjegjshëm për veprimtarinë e tyre edukative dhe rezultatet e saj.

Një prej kërkesave më të rëndësishme në fushën e mësimdhënies është bindja e mësuesit në aftësinë e nxënësve për të mësuar dhe që ai vetë është i aftë t'i mësojë ose t'i ndihmojë për të mësuar. Të mësuarit për qytetarinë demokratike përfshin edhe aftësi të tjera të mësimdhënies që janë të rëndësishme për procesin e aftësimin të nxënësve për t'u bërë qytetarë të përgjegjshëm:

- aftësia për t'i parë problemet nga këndvështrimi i nxënësit, duke marrë parasysh prejardhjen, moshën dhe nivelin e tij arsimor, si dhe aftësia për të mos paragjykuar qëndrimet dhe perceptimet që janë të ndryshme nga të tjerat;
- aftësia për të kuptuar, pranuar dhe respektuar ngjashmëritë dhe ndryshimet që ekzistojnë ndërmjet mësuesve dhe nxënësve si dhe ndërmjet nxënësve;
- respektimi i të drejtave të nxënësve dhe ndjeshmëria ndaj nevojave dhe interesave të tyre;
- aftësia për të trajtuar çështje të diskutueshme dhe për t'u përballuar me situata problematike dhe komplekse që mund të ndeshen në mjedisin shkollor;
- aftësia për ta parë veten dhe nxënësin si pjesëmarrës aktiv në komunitetin lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar;
- bindja në mundësinë e progresit dhe që çdo individ mund të ndihmojë në arritjen e tij;
- aftësia për të integruar përparësitë vetjake në një kuadër të përbashkët problemesh e vlerash dhe për të zbatuar në praktikë vendimet e marra nga nxënësi;
- gatishmëria për të pranuar gabimet para grupit dhe për të nxjerrë mësim prej tyre;
- aftësia për të shtruar dhe debatuar haptazi për probleme të diktuar nga kurrikula e fshehtë.

4. VLERËSIMI

Standardet e përmbajtjes së lëndës së edukimit qytetar përfshijnë tri elemente të ndërlidhur me njëri tjetrin: njohuritë, aftësitë intelektuale dhe ato të pjesëmarrjes dhe

prirjet qytetare. Të marrë së bashku këta elementë përbëjnë bazën për zhvillimin e edukimit qytetar dhe për rrjedhojë edhe vlerësimi i arritjeve të nxënësve duhet të pasqyrojë nevojën për të vlerësua shkëllën e përvetësimit të këtyre tri elementëve nga nxënësit.

Njohuritë përbëjnë thelbin e sistemit të vlerësimit dhe në përgjithësi mishërohen, për shembull, në pyetjet të tilla si:

- Cili është thelbi i qytetarisë dhe i jetës qytetare në demokraci?
- Cilat janë bazat mbi të cilat ngrihet sistemi demokratik në vend?
- Si dhe në çfarë shkalle sistemi politik në vend bazohet në qëllimet, vlerat dhe parimet e demokracisë të pranuar gjerësisht nga shoqëria jonë?
- Cili është roli i qytetarit në demokraci? Etj.

Aftësitë intelektuale dhe ato pjesëmarrëse të edukatës shoqërore përfshijnë përdorimin e njohurive për të menduar në mënyrë kritike dhe krijuese dhe për të vepruar me efektshmëri e në mënyrë të arsyeshme për të përballuar e zgjidhur sfidat e jetës demokratike në vend.

Aftësitë intelektuale aftësojnë nxënësi të mësojnë dhe të zbatojnë njohuritë qytetare në funksionet e shumta dhe të ndryshme të qytetarit. Këto aftësi i ndihmojnë qytetarët të identifikojnë, të përfshkruajnë, të shpjegojnë dhe të analizojnë informacionin dhe argumentet si dhe të vlerësojnë, marrin dhe mbrojnë qëndrime të caktuar për çështje të jetës publike.

Aftësitë pjesëmarrëse aftësojnë qytetarët të monitorojnë dhe të ndikojnë jetën publike dhe atë qytetare duke bashkëpunuar me të tjerët, duke formuluar dhe shprehur qartë idetë dhe itneresat e tyre, duke bërë koalicione, kërkuar konsensus, duke bërë marrëveshje dhe duke menaxhuar konfliktet.

Një vlerësim tërësor në lëndën e edukatës shoqërore nënkupton edhe vlerësimin, në atë shkallë që kjo është e mundur, të aftësive pjesëmarrëse. Kjo do të thotë se testimi duhet të përfshijë edhe *matjen e shkallësnë të cilën nxënësit kuptojnë përdorimin e duhur të aftësive pjesëmarrëse*. Këtu duhet të sqarohet se në këtë vlerësim nuk përfshihet matja e

drejtëpërdrejtë e aftësive pjesëmarrëse të nxënësve, për shembull, në qeverinë e nxënësve në shkollë ose në veprimtari të tjera publike.

Elementi i tretë janë *prirjet qytetare* dhe që përshkojnë të gjitha aspektet e qytetarisë. Në një sistem demokratik ato kanë të bëjnë me të drejtat dhe me përgjegjësitë e individëve në shoqëri dhe me çuarjen përpara të idealeve të qeverisjes demokratike.

Këtu përfshihen prirjet:

- për të qenë një anëtar i pavarur i shoqërisë,
- për të respektuar vlerat individuale dhe dinjitetin njerëzor,
- për të marrë përsipër përgjegjësitë personale, politike dhe ekonomike të qytetarit,
- për t'iu bindur “rregullave të lojës”, si pranimi i vendimit të ligjshëm të shumicës dhe respektimit të të drejtave të minoriteteve,
- për të marrë pjesë në çështjet qytetare në mënyrë të mirëinformuar, të arsyeshme dhe të efekshme
- për të nxitur dhe mbështetur funksionimin e shëndetshëm të demokracisë në vend.

Vlerësimi i prirjeve qytetare të nxënësve duhet të përqendrohet *në pyetje që kanë të bëjnë me njohjen e rëndësisë që kanë këto prirje për demokracinë. Vlerësimi në asnjë mënyrë nuk duhet të përfshijë pyetje që kanë të bëjnë me vlerat dhe prirjet personale të nxënësve të vlerësuar.*

Për këtë arsye, pyetjet që lidhen me prirjet qytetare duhet të lidhen me njohuritë dhe aftësitë intelektuale. Për shembull, nxënësit mund t'u kërkohet të përshkruajnë rëndësinë e dëgjimit me respekt të mendimeve dhe opinionëve të tjerëve. *Po kështu, nxënësve mund t'u matet aftësia për të vëzhguar dhe zbuluar shkallën e përputhjes së veprimtarisë së qeveritarëve ose institucioneve qeverisëse më parimet kushtetuese.*

Fitimi i njohurive, i aftësive dhe zhvillimi i prirjeve qytetare realizohen në kontekste të ndryshme si shtëpi, shkollë, bashkësi, shtet, rajon e më gjerë. Të gjitha këto përbëjnë edhe fushat kryesore në të cilat jo vetëm fitohen njohuritë dhe aftësitë por edhe zbatohen ato në praktikë.

KLASA E GJASHTË

Njohuri të reja:	27 orë
Përsëritje:	3 orë
Gjithsej:	30 orë

OBJEKTIVAT E LINJAVE

1. Individët, grupet, institucionet (8 orë)

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të dallojë rregullat nga ligjet.
- të argumentojë pse rregullat dhe ligjet janë të domosdoshme për jetën në grup.
- të analizojë disa nga ligjet që mundësojnë marrëdhënie të mira ndërmjet individit dhe grupit dhe anasjelltas.
- të demonstrojë vlera të tilla si e vërteta në grupet sociale ku bën pjesë, drejtësia
- të diskutojë për disa nga të drejtat dhe liritë e njeriut që lidhen me raportin e marrëdhënieve individ - grup social e si p.sh. e drejta e fjalës, e drejta e lojës, e drejta për të dashur për të qenë më i lirë etj.).
- të demonstrojë përgjegjësi të tilla si seriozitet, mbajtje e premtimit të dhënë, ndjekje e shkollës, respektimi i të tjerëve, etj.).
- të diskutojë rreth disa përgjegjësive që ndikojnë në parandalimin e krimit në moshën shkollore.
- të sqarojë kuptimin e fjalës atdhetarizëm.
- të diskutojë rreth drejtimeve (aspekteve) ku shfaqet atdhedashuria duke sjellë shembuj konkretë nga jeta e përditshme apo informacionet që marrin në burime të ndryshme.
- të diskutojë rreth qëllimeve të tilla të qeverisjes në komunitetin e tij si p.sh. për sigurimet e shërbimeve publike, mbrojtjen e mjedisit etj. Të shprehë mendimin e tij në lidhje me plotësimin e tyre.

- të përmendë figurat politike të shtetit e të komunitetit të tij (deputetët, anëtarët e qeverisë, gjykatës etj.), si edhe diçka rreth veprimtarisë së tyre në të mirën e atij komuniteti.
- të përmendë figurat e pushtetit lokal (kryetarin e komunës, të bashkisë, kryeplakun).
- të diskutojë rreth synimit të Këshillit të Evropës për rregullimin e territorit dhe të jetës së njeriut në komunitetet qytetare dhe fshatare.
- të demonstrojë vlera të bashkëpunimit me të tjerët për mbrojtjen e mjedisit dhe përmirësimin e jetës së njeriut në komunitetin e tij.

2. Idealet dhe praktikat e qytetarisë (7 orë)

Nxënësi duhet të jetë i aftë

- të tregojë kuptimin e fjalës minoritet, të përcaktojë minoritetet që ndodhen në vendin tonë dhe të diskutojë për vlerat e tyre.
- të tregojë ç'është përgjegjësia, cilat janë burimet e saj dhe të diskutojë për detyrat dhe përgjegjësitë që ai ka (në klasë, familje, komunitet) dhe rrugër për plotësimin e tyre.
- të shpjegojë rolin e njeriut për mbrojtjen e shëndetit duke luftuar (alkoolin, duhanin, drogën, SIDA-n dhe të demonstrojë disa masa që ndikojnë në parandalimin e tyre.
- të diskutojë për përgjegjësitë që kanë nxënësit, prindërit, shkolla dhe shoqëria në parandalimin e krimit.
- të hartojë një letër një zyrtari të pushtetit lokal për një problem që e shqetëson.
- të marrë pjesë në një shoqatë (të tregojë qëllimin e shoqatës dhe veprimtarinë që kryen ajo).
- të marrë pjesë në një juri të ngritur (në klasë apo shkollë) dhe të vlerësojë një aktivitet sportiv, artistik, etj.

3. Pushteti, autoriteti, qeverisja (7 orë)

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të tregojë ç'është ligji, cilat janë llojet e ligjeve, funksionet që ato kryejnë dhe të bëjë dallimin e ligjit nga zakoni.
- të hartojë një listë me disa ligje e zakone që i ndesh në shkollë, familje e komunitet.
- të diskutojë për domosdoshmërinë e ligjeve në jetën e përditshme (qytetare).
- të imagjinojë ngjarje rreth jetës pa rregulla në shkollë, familje, rrugë dhe komunitet.
- të përshkruajë ngjarje nga jeta, ku të vihen në dukje norma të tilla morale si vërtetësia, liria, drejtësia dhe të diskutojë për domosdoshmërinë e praktikimit të tyre në marrëdhënie me të tjerët.
- të paraqesë procedurën e përgatitjes së ligjeve.
- të përcaktojë çështjet që ndjekin organet e drejtësisë për zbatimin e ligjeve.
- të analizojë faktorët që çojnë në ndryshimin e ligjeve nga Parlamenti.
- të përshkruajë përgjegjësitë qytetare ndaj shtetit dhe institucioneve të tij.
- të diskutojë për liritë dhe të drejtat e individit në një shtet demokratik.
- të përshkruajë rrugën e hartimit, miratimit dhe zbatimit të ligjeve.
- të diskutojë si në një shtet demokratik pakicat kombëtare gëzojnë të gjitha të drejtat e liritë.
- të ilustrtojë të drejtat e fëmijëve që mbrohen me ligj.

4. Prodhimi dhe shpërndarja (5 orë)

Nxënësi duhet të jetë i aftë

- të identifikojë dhe të vlerësojë aftësitë dhe interesat e tij dhe t'i lidhë ato me botën e punës
- të zbulojë mundësitë e ndryshme në fushën e karrierës
- të identifikojë burimet e informacionit që lidhet me tregun e e punës
- të kërkojë dhe të zbulojë vende të ndryshme pune duke përdorur informacionin që ofrojnë gazetat ose media elektronike
- të diskutojë dhe argumentojë rëndësië e arsimit në fushën e punës
- të ndërtojë një buxhet modest personal ose familjar për shpenzimet e një muaji etj.

KLASA E SHTATË

Njohuri të reja:	27 orë
Përsëritje:	3 orë
Gjithsej:	30 orë

OBJEKTIVAT E LINJAVE

1. Individët, grupet, institucionet (3 orë)

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të argumentojë faktin që vetëm në një shtet demokratik mund të arrihet konsensusi shoqëror.
- të diskutojë nëpërmjet shembujve konkretë rreth atyre burimeve të autoritetit që harmonizojnë marrëdhëniet në grupin shoqëror ku ai bën pjesë (si p.sh. rregullat dhe ligjet, zakonet, traditat etj.).
- të demonstrojë aftësi për marrjen e vendimeve të drejta në jetën e përditshme (në grupin social ku bën pjesë, në klasë, shkollë apo në komunitet).
- të listojë disa fakte e opinione për probleme të ndryshme të jetës në grupin social, në shkollë apo në komunitetin ku bën pjesë.

2. Organizimi dhe funksionimi i shtetit demokratik (4 orë)

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të radhisë disa nga parimet e shtetit demokratik dhe të përshkruajë veprimin e tyre në jetën e komunitetit të tij.
- të përshkruajë figurën e një presidenti dhe të një monarku (duke evidentuar të drejtat dhe detyrat e tij).
- të përshkruajë strukturat vertikale të pushtetit.
- të shpjegojë organizimin e pushtetit lokal, funksionimin e tij dhe lidhjet me pushtetin qendror.

- të diskutojë për institucionin e Presidentit, si organ i veçantë, që ngrihet mbi interesat partiake dhe përfaqëson unitetin e kombit dhe aspiratat e shtetasve.
- të vlerësojë mënyrat me të cilat pushteti lokal ndikon në jetën e njerëzve të komunitetit.
- të vlerësojë rolin e partive politike dhe rëndësinë e tyre në politikën shqiptare.
- të shpjegojë rëndësinë e ligjeve kushtetuese në mbrojtjen e të drejtave të njeriut.
- të diskutojë dhe të demonstrojë aftësi në vlerësimin e rëndësisë të votimeve e të zgjedhjeve në vendin tonë.
- të diskutojë dhe të vlerësojë për marrëdhëniet pozitive – opozitive.
- të grumbullojë materiale nga shtypi ku jepen njoftime për punën që bën qeveria për plotësimin e qëllimeve të saj.

3. Format e pushtetit (5 orë)

- të përshkruajë organizimin dhe të shpjegojë funksionet e pushtetit legjislativ.
- të diskutojë për funksionet dhe kompetencat e parlamentit, si organ ligjvënës.
- të diskutojë për rolin që luan shteti për zbatimin e ligjeve.
- të paraqesë procedurën që ndjek Parlamenti në hartimin dhe miratimin e ligjeve.
- të shpjegojë funksionet e pushtetit gjyqësor.
- të diskutojë për parimin : “Para ligjit janë të gjithë të barabartë”.
- të përshkruajë organizimin dhe të shpjegojë funksionet e pushtetit ekzekutiv.
- të shpjegojë mënyrat që përdor pushteti ekzekutiv dhe ai gjyqësor në zbatimin e ligjeve.
- të përshkruajë duke shfrytëzuar njohuritë e marra nga lënda e historisë, natyrën e shtetit në formacionet ekonomiko-shoqërore që ka kaluar njerëzimi.
- të vlerësojë ndryshimet ndërmjet shteteve totalitare, monopartiakë, diktatorialë dhe të shtetit shqiptar në ditët tona.
- të përshkruajë cilësitë që duhet të ketë një kandidat për deputet sipas mendimit të tij.
- të shpjegojë se çfarë kupton me autoritet dhe pse duhet respektuar autoriteti i një qeveritari, deputeti, polici, etj.
- të përshkruajë sipas mendimit të tij zbatimin e një demokracie ideale në Shqipëri.

4. Opinioni (3 orë)

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të tregojë ç'kupton me opinion shoqëror dhe të analizojë ndikimin e formave të tij në veprimtarinë e qeverisë.
- të marrë opinione të qytetarëve në komunitetin e tij mbi veprimtarinë e qeverisë dhe t'i diskutojë në klasë.
- të diskutojë për metodat që përdor propaganda për të rritur ndieshmërinë e opinionit publik për një çështje të caktuar.
- të paraqesë në klasë shembuj faktesh dhe opinionesh dhe të bëjë krahasimin dhe dallimin midis tyre.
- të hartojë një listë, ku të rendisë raste gjykimi për çështje civile, penale dhe administrative.

5. Prodhimi dhe shpërndarja (7 orë)

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të identifikojë të mirat dhe shërbimet që dëshiron dhe blejë shpesh dhe të diskutojë se si biznesi ndikon në jetën e tij.
- të përshkruajë burimet e nevojshme për të funksionuar një biznes dhe të zhvillojë një plan të thjeshtë biznesi.
- të vlerësojë koston e prodhimit të një të mire ose shërbimi të caktuar.
- të bëjë eksperimente për të përcaktuar rrugën më të efektshme për të prodhuar një të mirë ose shërbim me cilësi të lartë.
- të përshkruajë se si funksionon një treg.
- të eksplorojë strategjitë e reklamës dhe të zhvillojë vetë një fushatë reklamash.
- të veprojë në mënyrë konkurrenciale në një treg kapitali të shitjeve me shumicë për të krijuar grafikun e kërkesës dhe të ofertës dhe për të zbuluar si vendosen çmimet e tregut.
- të shpjegojë se si shpenzimet e biznesit bëhen të ardhura për të tjerët.
- të diskutojë problemet më të zakonshme etike dhe ekonomike të biznesit.
- të identifikojë tipet e të mirave dhe të shërbimeve më të zakonshme që ofrohen nga qeveria.

- të identifikojë interesat dhe aftësitë e tij personale dhe t'i lidhë ato me mundësitë e punës.
- të lidhë synimet e tij të karrierës me kërkesat e veçanta të arsimimit të tij.
- të zbulojë burimet e informacionit për punësim dhe të përdorë gazetat lokale për të identifikuar mundësitë e punësimit.

6. Ideat dhe praktikat e qytetarisë (5 orë)

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të identifikojë të drejtat të njeriut në dokumentat kryesore dhe në kushtetutën shqiptare.
- të dallojë kategoritë kryesore të të drejtave.
- të diskutojë rreth çështjeve që kanë të bëjnë me të drejtat personale (si vishen)
- të identifikojë të vlerësojë dhe të diskutojë rreth rëndësisë së respektimit dhe realizimit për vete dhe për të tjerët të të drejtave të njeriut.
- të identifikojë raste të shkeljes së të drejtave të tij dhe të tjerëve në klasë, familje dhe komunitet.
- të shpjegojë me fjalët e tij se të drejtat veprojnë në një fushë të caktuar dhe ato kanë kufizimet e tyre.
- të dallojë raste të kufizimit të të drejtave në jetën e përditshme (familje, klasë etj) dhe të tregojë se të drejtat kufizohen nga nevoja për të respektuar të drejtat e tij dhe të të tjerëve.
- të diskutojë për format që mund të përdorin nxënësit në marrjen e vendimeve.
- të diskutojë për gjendjen e ujit të pijshëm, e ndotjes së mjedisit në komunitetin e tij si dhe për përgjegjësinë e komunës ose të bashkisë në zgjidhjen e tyre.
- të hartojë një letër për përfaqësuesit e pushtetit lokal ose për deputetin që përfaqëson zonën e tij në Parlament ku të shprehë shqetësimet e komunitetit të tij.
- të marrë vendime dhe të përpiqet për zbatimin e tyre.
- të marrë pjesë në aksione konkrete në dobi të mjedisit (pastrim territori, mbjellje pemësh, lyerjen e trungjeve me gëlqere etj.).

- të përgatisë një faqe gazetë dhe të bëjë analizën e leximit të saj sipas udhëzimeve të dhëna.

KLASA E TETË

Njohuri të reja:	28 orë
Përsëritje:	2 orë
Gjithsej:	30 orë

Synime të veçanta të lëndës edukata shoqërore për klasën e tetë

Lënda e Edukatës qytetare e klasës së tetë duhet t'i shërbejë *zhvillimit të njohurive, të aftësive intelektuale dhe të prirjeve qytetare të nxënësve*. Nëpërmjettij programi **synohet:**

- të ndihmohen nxënësit të kuptojnë se pikëpamja e tyre për botën formohet dhe kufizohet nga përvoja e tyre vetjake, si dhe nga kultura, klasa, kombësia, raca, gjinia, brezi ku bën pjesë etj. (*Këndvështrime të kufizuara*)
- të ndihmohen nxënësit të mësojnë rreth mënyrës së tyre të jetesës nëpërmjet studimit të faktit si të tjerët e shohin atë. (*Si na shohin të tjerët*)
- të ndihmohen nxënësit të mësojnë faktet kryesore e kuptimplote/të rëndësishme gjeografike, politike, shoqërore dhe ekonomike të botës. (*Faktet*)
- të ndihmohen nxënësit të kuptojnë çështjet, prirjet dhe zhvillimet globale. (*Çështjet*)
- të ndihmohen nxënësit të kuptojnë natyrën e ndërvarur dhe sitemike të botës. (*Ndërvarësia*)
- të ndihmohen nxënësit të kuptojnë dhe të ndjejnë mendimet dhe ndjenjat e të tjerëve, veçanërisht të atyre që u përkasin kulturave, klasave, kombësive, racave, gjinive dhe brezave të ndryshëm. (*Empatia*)
- të ndihmohen nxënësit të zhvillojnë shprehitë e analizës kritike për të qenë të aftë të zbulojnë njëanshmëritë dhe për të formuar gjykimin e tyre për atë çfarë mësojnë nga media informative etj. dhe për atë që dëgjojnë në klasë. (*Shprehitë kritike*)

- të ndihmohen nxënësit të bëhen të vetëdijshëm për anët e tyre të forta dhe të dobëta, njëanshmëritë dhe paragjykimet dhe të ndihmohen ata të arrijnë të vlerësojnë dhe të respektojnë veten. (*Njohja e vetvetes*)
- të ndihmohen nxënësit të kuptojnë të përbashkëtat në nevoja, në talente dhe dëshira në të gjithë botën. (*E përbashkëta*)
- të ndihmohen nxënësit të imagjinojnë, të përfytyrojnë dhe të respektojnë për të ardhmet e mundshme në nivel vetjak, lokal, kombëtar dhe global dhe të ndihmohen ata të zhvillojnë shprehitë e nevojshme për të arritur të ardhmet e dëshiruara. (*E ardhmja*)
- të ndihmohen nxënësit të mësojnë si të përballen dhe të arrijnë të kontrollojnë fatin e tyre në një botë gjithnjë e në ndryshim. (*Shmangia e shokut psikologjik*)
- të ndihmohen nxënësit të zhvillojnë dhe të praktikojnë shprehitë e nevojshme për pjesëmarrje aktive dhe demokratike në bashkësinë e shkollës, të lagjes, vendit dhe të bashkësisë botëror. (*Pjesëmarrja*)
- të ndihmohen nxënësit të kuptojnë konceptin e ndryshimit, si dhe mjetet dhe rrugët për të ndikuar në të. (*Ndryshimi i botës*)
- të ndihmohen nxënësit të zhvillojnë shprehitë e komunikimit efektiv, përfshirë shprehitë e të dëgjuarit, shprehitë e të shprehurit gojor dhe me forma të tjera. (*Komunikimi*)
- të ndihmohen nxënësit të vlerësojnë pasurinë kulturore që ofrojnë kulturat brenda dhe jashtë grupeve shoqërore ku bëjnë pjesë. (*Pasuria kulturore*)
- të ndihmohen nxënësit të zhvillojnë respektin e tyre për të drejtat, ndjenjat dhe vlerën dhe dinjitetin e qenieve njerëzore dhe qenieve të gjalla. (*Respekti*)
- të ndihmohen nxënësit të kuptojnë dhe të provojnë në praktikë rëndësinë e bashkëpunimit dhe të zhvillojnë shprehitë e duhura, si: shprehitë për shmangien dhe zgjidhjen e konflikteve. (*Bashkëpunimi*)

- të ndihmohen nxënësit të vlerësojnë se marrëdhëniet ndërmjet individëve, grupeve dhe shoqërisë duhet të ngrihen mbi bazën e barazisë. (*Barazia*)
- të ndihmohen nxënësit të kuptojnë se parimi i drejtësisë nënkupton pjesëmarrjen e drejtpër drejtë për të mbrojtur të drejtat e të tjerëve. (*Drejtësia*)
- t'u paraqiten nxënësve alternativa dhe vizione të ndryshme të realitetit, si dhe strategji për të arritur ndryshime vetjake dhe shoqërore. (*Vizionet alternative*)
- të ndihmohen nxënësit të zhvillojnë shprehitë e duhura studimore, si: planifikimi, organizimi dhe ndjekja e hulumtimeve të pavarura, nxjerrja dhe vlerësimi i përfundimeve. (*Shprehitë e studimit*)

Shënim.

Synimet e përgjithshme dhe ato të veçanta, të radhitura më sipër, si dhe konceptet kryesore të lëndës (në kllapa) do të realizohen, në shkallën më të madhe që mundëson mosha e nxënësve në klasën e tetë, përmes objektivave të mësipërm.

Për të shmangur përsëritjen e aftësive intelektuale dhe të aftësive pjesëmarrëse që synohen të realizohen përmes këtij programi, në vijim është përcaktuar korniza në të cilin ato do të realizohen. Kjo mundëson dhe kërkon përdorimin e aftësive krijuese të përdoruesve të këtij programi si të autorëve të tekstit, ashtu edhe të mësuesve në shfrytëzimin sa më të mirë të kësaj kornize.

OBJEKTIVAT E LINJAVE

I. Ndërvarësia e individit me të tjerët (7 orë)

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë dhe të shpjegojë ndërvarësinë e jetës njerëzore në nivel
 - vetjak,
 - familjar,
 - komunitar,

- kombëtar,
- rajonal,
- botëror.
- të përshkruajë marrëdhëniet e tij (çfarë merr dhe çfarë jep):
 - me individët e tjerë,
 - me grupin shoqëror ku bën pjesë,
 - me familjen,
 - me lagjen,
 - kombin,
 - me rajonin etj.
- të përshkruajë si kanë ndryshuar këto marrëdhënie gjatë jetës së tij.

II. Ndërvarësia e individit me mjedisin kulturor kombëtar dhe rajonal (7 orë)

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të dallojë disa nga tiparet e identitetit kombëtar:
 - të identifikojë dhe të përshkruajë veçoritë e tij në kuadrin e mjedisit kulturor në të cilin bën pjesë (ku dallon nga shokët e klasës ose të mjedisit ku jeton).
 - të identifikojë dhe të përshkruajë të përbashkëtat me nënkulturat e tjera (cilat janë të përbashkëtat që ai ka me shokët e klasës ose të lagjes ku jeton).
- të dallojë tiparet e identitetit evropian (eksplorimi i Evropës):
 - të identifikojë disa nga veçoritë që mendon se i takojnë qytetarit evropian.
 - të eksplorojë disa nga fushat kryesore të jetës në Evropë, si: kultura, muzika, veshja, mjedisi etj..
 - të përshkruajë disa nga tiparet e njohura të fqinjëve tanë.
- të dallojë dhe të përshkruajë tipare, ide, qendrime që janë të veçanta për kulturën tonë krahasuar me ato të kulturave të tjera:
 - të përshkruajë veten e tij si qytetar i Shqipërisë.
 - të përshkruajë veten e tij si qytetar i Evropës.
- të përshkruajë anët pozitive dhe negative të të qenit vetëm shqiptar.

III. Lidhja dhe ndërvarësia e shqipërisë me fqinjët, evropën dhe botën (7 orë)

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të dallojë dhe të përshkruajë disa nga pikat e kontaktit të vendit tonë me Evropën:
 - në fushën kulturore,
 - në fushën ekonomike,
 - në fushën shoqërore,
 - në fushën arsimore,
 - në fushën shtetërore,
 - në fushën ligjore.
- të përmendë organizmat ndërkombëtare në nivel evropian dhe botëror, si: OKB, Këshilli i Evropës dhe Bashkimi Evropian, strukturat dhe qëllimet themelore të veprimtarisë së tyre.
- të shpjegojë rëndësinë e bashkëpunimit të Shqipërisë me secilin prej këtyre organizmave, parë ky bashkëpunim në planin ekonomik, kulturor, social, politik etj.
- të shpjegojë rolin e organizmave në ngjarje të caktuara dhe mënyrat si ato ndihmojnë në zgjidhjen e konflikteve të ndryshme në botë.
- të analizojë shembuj nga jeta e përditshme ose nga media të formave të bashkëpunimit të Shqipërisë me Këshillin e Evropës, OKB-në dhe Bashkimin Evropian.
- të vlerësojë si ndikon në jetën e individit bashkëpunimi me këto organizma.
- të vlerësojë si ndikon në jetën komunitetit dhe të kombit bashkëpunimi me këto organizma.
- të tregojë rrugët e bashkëpunimit ndërkombëtar në të mirë të parandalimit të problemeve të ndryshme globale.
- të demonstrojë vlera të respektimit dhe solidaritetit me vendimet e marra nga organizmat ndërkombëtare në mirë të paqes botërore.

IV. Disa nga problemet globale dhe veprimi politik dhe qytetar në kuadrin e ndërvarësisë globale (7 orë)

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të evidentojë format e shfaqjes së problemeve globale, si: ndotja e mjedisit, ruajtja e burimeve natyrore etj. në vendin tonë.
- të analizojë shkaqet dhe pasojat që sjellin problemet e mjedisit në bashkësinë e tij, në Shqipëri dhe më gjerë.
- të vlerësojë në mënyrë kritike qëndrimet e politikës vendëse ndaj problemeve globale.
 - të identifikojë disa nga problemet globale që ndeshen në lagjen, bashkësinë ose në vendin e tij.
 - të identifikojë disa nga politikat e ndërmarra për të zgjidhur problemin nga:
 - pushteti lokal,
 - shteti,
 - organizata joqeveritare.
- të ndërmarrë veprime konkrete që kanë pasoja jo vetëm për mjedisin ku jeton, por edhe më gjerë
- të demonstrojë aftësi praktike për të ndërmarrë veprime konkrete në të mirë të përmirësimit të situatës mjedisore në komunitet.

KLASA E NËNTË

Njohuri të reja:	28 orë
Përsëritje:	2 orë
Gjithsej:	30 orë

OBJEKTIVAT E LINJAVE

I. Çështë demokracia? (6 orë)

Nxënësit duhet të jenë të aftë:

- të japin një përkufizim të demokracisë.
- të dallojnë konceptet e ndryshme për demokracinë.
- të krahasojnë pushtetet shtetërore që vlerësohen të ligjshme me ata që vlerësohen si jo të tillë krahasuar me tiparet që burojnë nga përcaktimi i demokracisë.
- të dallojnë tipet e ndryshme të demokracisë.
- të listojnë karakteristikat kryesore të demokracisë.
- të dallojnë argumentet që mbështesin dhe ata që i kundërvihen demokracisë.
- të mbajnë dhe shprehin qëndrimin e tyre ndaj demokracisë dhe tipareve të saj.
- të vlerësojnë mendimet dhe qëndrimet e tyre duke i krahasuar me kërkesat e mendimit dhe veprimti demokratik.
- të identifikojnë, përshkruajnë dhe diskutojnë për elemente të demokracisë në bashkësinë ku jetojnë dhe në realitetin shqiptar.
- të vlerësojnë praktikën e demokracisë në bashkësinë ku jetojnë dhe në realitetin shqiptar.
- të parashikojnë zhvillime të mundshme të fushave të ndryshme të realitetit shqiptar duke u nisur nga praktikën dhe prirjet aktuale që vihen re në të.

II. Faktorët që ndihmojnë, pengojnë demokracinë (5 orë)

Nxënësit duhet të jenë të aftë:

- të përcaktojnë disa nga faktorët që mbështesin dhe pengojnë demokracinë.

- të shprehin mendimin e tyre lidhur me ekzistencën e faktorëve të tillë në bashkësinë ku jetojnë dhe realitetin shqiptar në përgjithësi.
- të japin një përcaktim lidhur me tiparet e realitetit në Shqipëri që mund të rrezikojnë demokracinë.
- të identifikojnë faktorët që ushqejnë lindjen dhe veprimin e faktorëve që rrezikojnë demokracinë në Shqipëri.
- të diskutojnë për mundësinë e zvogëlimit të veprimit të faktorëve që rrezikojnë demokracinë në Shqipëri.

III. Funkcionimi i demokracisë (11 orë)

Nxënësit duhet të jenë të aftë:

- të përshkruajnë disa nga çështjet që duhet të zgjidhë demokracia.
- të identifikojnë çështjet që janë parësore për t'u zgjidhur nga demokracia shqiptare në rrugën e forcimit të saj të mëtejshëm.
- të diskutojnë për rolin e institucioneve në realitetin shqiptar.
- të vlerësojnë veprimtarinë e institucioneve në Shqipëri duke i krahasuar me qëllimet dhe vlerat e demokracisë.
- të përshkruajnë strukturën e qeverisjes në një demokracisë.
- të diskutojnë për mënyrën e funksionimit të degëve të ndryshme të pushtetit në Shqipëri.
- të dallojnë elementë demokratikë ose jo demokratikë në funksionimin e pushtetit dhe të degëve të ndryshme të tij në Shqipëri.
- të identifikojnë faktorë të ndryshëm ekonomikë, shoqërorë, politikë, psikologjikë etj., që ndikojnë në cilën e funksionimit të pushtetit demokratik në Shqipëri.
- të shprehin mendimin e tyre për zgjidhjen e problemeve që lidhen me përmirësimin e funksionimit të demokracisë në Shqipëri.
- të përcaktojnë rolin e individëve në demokraci dhe të gjykojnë për rolin e individëve në shoqërinë shqiptare në drejtim të zhvillimit ose pengimit të proceseve demokratike.
- të listojnë kritere për të gjykuar për politikën publike në demokraci.

- të shprehin mendimin e tyre për politikën publike në bashkësinë ku jetojnë dhe atë në Shqipëri.
- të përshkruajnë rolin partive politike në demokraci dhe marrëdhëniet ndërmjet institucioneve qeveritare dhe partive politike.
- të përshkruajnë rolin e shoqërisë civile në demokraci.
- të përshkruajnë rolin e zgjedhjeve në një demokraci.
- të diskutojnë për rëndësinë e zbatimit të procedurave të drejta të votimit.
- të diskutojnë për rëndësinë e tolerancës politike dhe të pranimit të rezultateve të zgjedhjeve (dhe të humbjes së zgjedhjeve) demokratike në një demokraci.
- të diskutojnë për karakterin demokratik ose të zgjedhjeve në Shqipëri, gjatë viteve të fundit.
- të identifikojnë elemente demokratike ose jo në realitetin zgjedhor në Shqipëri etj.

IV. Pjesëmarrja qytetare (6 orë)

Nxënësit duhet të jenë të aftë:

- të diskutojnë për rëndësinë e pjesëmarrjes qytetare në demokraci.
- të diskutojnë për rëndësinë që ka të qenit qytetar i informuar për cilësinë e pjesëmarrjes qytetare.
- të përshkruajnë disa nga rrugët e realizimit të pjesëmarrjes qytetare në demokraci.
- të diskutojnë për mundësitë dhe rrugët e rritjes së pjesëmarrjes qytetare në realitetin ku jetojnë (lagje, shkollë, fshat, qytet etj.).